



Asbesti – material i rrezikshëm

Azbesti është i ndaluar në Zvicër prej vitit 1989. Megjithatë, për çdo vit në Zvicër ende sëmurën rëndë rreth 120 persona, si pasojë e kontaktit me këtë materie. Fshehtësia: Sëmundja shfaqet edhe pas 20 deri 40 viteve, nganjëherë madje edhe më vonë.

Thithja e fibrave të azbestit është përgjegjëse për sëmundjet si Azbestoza (pluhuri në mushkëri), Mezoteliomi (tumori i keq në stomak dhe në pleurë). Kjo e fundit shpesh përfundon me vdekje.

Azbesti është përdorur me të madhe sidomos në vitet 1960 dhe 70, sikurse në ndërtimtarë, në zejtarë dhe po ashtu në industri. Madje edhe sot, në rastet e riparimeve dhe punëve për sanimin e ndërtesave të vjetra, haset azbesti dhe rrezikon shëndetin.

Angazhimi i Unia kundër azbestit

Ka kohë që sindikata Unia angazhohet për një përballje të denjë dhe gjithëpërfshirëse me fatkeqësinë e asbestit.

Në fillim të viteve 1980, me angazhimin e vet Sindikata e ndërtimtarisë dhe e drurit, një organizatë paraardhëse e Unia, ishte në krye të frontit për ndalimin e azbestit. Që atëherë, në bashkëpunim me SUVA dhe me partnerët socialë, është bërë shumë, sidomos në fushën e parandalimit.

Informata të sindikatës Unia për azbestin:
www.unia.ch/asbest, info-asbest@unia.ch

**A keni pyetje rreth asbestit?
Ne ju mbështesim me kënaqësi!**

Unia në afërsinë Tuaj:

Aargau T 0848 333 003, aargau@unia.ch

Bern T 031 385 22 22, bern@unia.ch

Berner Oberland T 033 225 30 20, thun@unia.ch

Biel-Seeland/Solothurn T 032 329 33 33, biel-solothurn@unia.ch

Fribourg T 026 347 31 31, fribourg@unia.ch

Genève T 0848 949 120, geneve@unia.ch

Neuchâtel T 0848 203 090, neuchatel@unia.ch

Nordwestschweiz T 0848 113 344, nordwestschweiz@unia.ch

Ostschweiz-Graubünden T 0848 750 751, ostschweiz-graubunden@unia.ch

Ticino T 091 910 50 70, ticino@unia.ch

Transjurane T 0848 421 600, transjurane@unia.ch

Vaud T 0848 606 606, vaud@unia.ch

Valais T 027 606 60 00, valais@unia.ch

Zentralschweiz T 041 249 93 00, zentralschweiz@unia.ch

Zürich-Schaffhausen T 044 296 18 18, zuerich-schaffhausen@unia.ch

Fotot: «100 të vdekur nga azbesti» – me bustet e tyre nga gjipsi dhe materialet ndërtimore, artistët italicezë Luigi Boccadamo, Diego Giabardo dhe Roberto Mucchiut përkujtojnë mbi 100 viktimat të azbestit në Zvicër.



**Përkrahja për viktimat
e azbestit**

Fondi për kompensim dhe Shërbimi i Kujdesit

+41 41 418 89 79
www.stiftung-efa.ch

UNIA

Përkrahja financiare dhe psikologjike e viktimave të azbestit dhe të afërmve të tyre



Fondi për kompensim

Që nga vera e vitit 2017, Fondi për kompensim të viktimave të azbestit (EFA) ofron ndihmë të shpejtë dhe të thjeshtë për personat e prekur dhe të afërmit e tyre – një arritje e rëndësishme kjo për tejkalimin e katastrofës së azbestit.

Pasojat e një ekspozimi ndaj azbestit gjatë jetës së punës, në parim sot njihen si sëmundje profesionale dhe sigurohen nga Suva. Më keq është puna me personat të cilët nuk kanë pasur kontakt profesional me azbestin dhe megjithatë janë sëmurë, ngase për shembull bashkëshortet i kanë pastruar rrobat e punës të pluhurosura me azbest të burrit. Deri më tani ato kanë pranuar vetëm shërbime nga sigurimet shëndetësore dhe të invaliditetit, të cilat janë shumë më të ulëta.

Fondi sjell përmirësime

Fondit të ri synon një përkrahje të barabartë për të gjithë viktimat e azbestit. Kjo është një arritje e rëndësishme e luftës së sindikatave kundër efekteve shkatërruese të asbestit.

Fondacioni i Fondin për kompensimin e viktimave të azbestit (EFA), është rezultat i një tryeze të rumbullakët kombëtare, e cila është iniciuar nga sindikatat dhe në të cilën Unia ka marrë pjesë në mënyrë aktive. Lidhja e Sindikatave të Zvicrës (SGB) është e përfaqësuar në bordin udhëheqës të Fondacionit.

Kërkesën tuaj drejtonë në:

Stiftung Entschädigungsfonds für Asbestopfer
Service-Center Gesuche
Fluhmattstrasse 1, Postfach 4358, CH-6002 Luzern

E drejta për kompensim

Kompensimi financiar nga Fondacioni në parim u dedikohet **viktimave me Mezotelion (një lloj tumori i keq në stomak dhe në pleurë)**. Personat e sëmurë nga mezoteliomi që nga viti 2006, mund të bëjnë një kërkesë në EFA.

Parimisht vlejné këto kritere:

- Oferta u drejtohet në radhë të parë personave, Mezoteliomi i të cilëve **nuk njihet si sëmundje profesionale**.
- Për personat me një mezoteliom që njihet **si sëmundje profesionale**, po ashtu janë të mundshme përfitimet në kushte të caktuara.
- Kontakti me azbest duhet të ketë ngjarë **në Zvicër**.
- Për kompensimin retroaktiv **kërkesat duhet të shtrohen deri më 30 qershor 2020**.
- Personat të cilët janë paraqitur për një kompensim nga EFA, heqin dorë nga e drejta për ankesa gjyqësore sipas të drejtës civile.

Në raste të rënda, EFA mund të ofrojë shërbime financiare për personat **me sëmundje të tjera që lidhen me asbest**.

Pyesni në çdo rast – ia vlen!

Këshillimi psikologjik (Care Service)

Krahas kujdesit mjekësor, për viktimat e azbestit shumë e rëndësishme është edhe këshillimi psikologjik i të sëmurëve nga azbesti dhe i të afërmve të tyre.

Këta të fundit deri më tani nuk kanë përfituar nga kjo. Prandaj, Fondacioni EFA së bashku me ligat rajonale të mushkërive kanë lansuar një Shërbim të Kujdesit me këshilla dhe përkrahje psikologjike falas. Ky shërbim vlen për të gjithë personat, pa marrë parasysh mënyrën e sëmundjes nga azbesti.

Mos ngurroni që të drejtoheni me pyetjet tuaja pranë Shërbimit të Kujdesit!

Fondacioni i Fondit për kompensim të viktimave të azbestit është në dispozicionin tuaj nëse keni ndonjë pyetje. Informacione në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht:

T +41 41 418 89 79
info@stiftung-efa.ch, www.stiftung-efa.ch